

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Goal: BARAZI GJINORE

Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

Target: 5.2

5.2 Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit.

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike	Neni 7
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike	Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës dhe as dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore e poshtëruese. Në veçanti, askush nuk duhet t'i nënshtrohet një eksperimenti mjekësor ose shkencor pa pëlqimin e tij të lirë.
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj	Neni 3
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj	Ndalimi i torturës
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut	Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve Çnjerëzore ose poshtëruese.
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut	Neni 3
	Gjithkush ka të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personalitetit.
	Neni 2.1
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	1.Shtetet palë respektojnë dhe i sigurojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, pa aftësia, prejudhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë,
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Neni 2.2

Konventa për të Drejtat e Fëmijës
Konventa për të Drejtat e Fëmijës

2. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij

Neni 19

Konventa për të Drejtat e Fëmijës
Konventa për të Drejtat e Fëmijës

1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.

2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, nëse duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Neni 34

Konventa për të Drejtat e Fëmijës
Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që:

(a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;

(b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;

(c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Neni 19.2

Konventa për të Drejtat e Fëmijës
Konventa për të Drejtat e Fëmijës

19.2

Masat e tilla mbrojtëse, siç duhet, duhet të përfshijnë efektive procedurat për krijimin e programeve sociale për të siguruar mbështetjen e nevojshme për fëmijën dhe për ata që kanë kujdesin e fëmijës, si dhe për format e tjera të parandalimit dhe për identifikimin, raportimin, referimin, hetimin, trajtimin dhe përcjelljen e instancave të keqtrajtimit të fëmijëve të përshkruar deri më tani, dhe, sipas rastit, për përfshirje gjyqësore.

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Konventa për të Drejtat e Fëmijës	Neni 34.a
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	a. Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	Neni 34.b
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	b. Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	Neni 34.c
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	c. Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	Neni 35
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Ligjet

Nenet

Neni 1

LIGJI Nr. 03/L-182 PËR
MBROJTJE NGA DHUNA
NË FAMILJE
LIGJI Nr. 03/L-182 PËR
MBROJTJE NGA DHUNA
NË FAMILJE

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktime të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.